



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Komuna e **DEÇANIT** 2024

PLANI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2024



PËRMBAJTJA

Hyrje	2
ZYRA E KRYETARIT	2
Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun	3
Zyra e Prokurimit	6
Zyra e Auditorit të Brendshëm	11
Zyra e Personelit	11
Zyra për Komunitete dhe Kthim	11
DREJTORIA E ADMINISTRATËS	14
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM HAPËSINOR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	14
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	19
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	21
DREJTORIA PËR ARSIM	40
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	52
DREJTORIA PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE SHËRBIME PUBLIKE	55
DREJTORIA PËR INSPEKSION	60
DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM	63
DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTËR	72
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT.....	75

Hyrje

Plani Vjetor i Punës është bazuar në nevojat e qytetarëve me prioritet, nga bashkëpunimi gjatë dëgjimeve buxhetore, të hartuara dhe të përpiluara nga ekipi profesional i qeverisjes komunale. Ky plan përmban prioritetet, objektivat dhe aktivitetet kryesore që planifikohen gjatë vitit 2024. Nëpërmjet këtij plani, në vija të trasha orientohet puna e kryetarit dhe qeverisjes komunale për plotësimin dhe realizimin e kërkesave të qytetarëve.

Mirëpresim gjithashtu angazhimin dhe kontributin e qytetarëve dhe të organizatave të ndryshme, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve të komunës përmes një ekzekutivi funksional dhe të përgjegjshëm.

Gjithashtu përmes njoftimeve publike, web faqes së komunës, rrjeteve sociale, diskutimeve publike me qytetarë, do të ju mbajmë të informuar me ecurinë e vazhdimin të projekteve dhe punëve të përditshme gjatë gjithë vitit.

Plani i punës është plan dinamik pune, i cili mund të ndryshohet sipas kërkesave, nevojave dhe ndryshimit të rrethanave.

➤ Zyra e Kryetarit

Gjatë vitit 2024 Zyra e Kryetarit të Komunës së Deçanit do të kryej këto punë:

- Organizimin e takimeve protokollare të kryetarit të komunës;
- Evidentimin dhe mbikëqyrjen e takimeve të kryetarit të komunës;
- Përgatitjen e takimeve të kryetarit me delegacione të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, nga niveli qendror dhe lokal;
- Organizimin e takimeve të kryetarit me qytetarët e Komunës së Deçanit;
- Organizimin e së paku dy Mbledhjeve Publike ashtu siç e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale;
- Do të pranoj dhe përgadit kërkesa të ndryshme, të përpiloj shkresa, njoftime dhe të kryej punë të tjera administrative varësisht nga nevoja apo kërkesa e kryetarit të komunës.

➤ Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun

Ndër aktivitetet kryesore parashihen të jenë:

- Publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari;
- Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit dhe Drejtorive Komunale;
- Dërgimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari në MAPL;
- Pranimi i kërkesave për qasje në dokumente publike dhe kthimi i përgjigjes bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike;
- Përgatitja e Raportit për Qasje në Dokumente Publike;
- Publikimi i njoftimeve për mbledhjet e Kuvendit Komunal, KPF-së dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë komunës;
- Publikimi i Raportit të Punës së Kryetarit dhe drejtorëve dhe zyrtarëve komunal;
- Përgatitja e raportit për Zyrën për Informim;
- Përgatitja e njoftimeve për mbajtjen e Takimeve, Konsultimeve dhe Dëgjimeve Buxhetore publike me qytetarë;
- Publikimi i dokumenteve në webfaqe si dhe në Platformën e Konsultimeve Publike si: rregullore, strategji dhe plane të ndyshme;
- Përgatitja e njoftimeve për aktivitete përkujtimore, ngjarje e përvjetorë e për data të rëndësishme;
- Publikimi i dokumenteve-rezultateve të përgatitura nga OJQ-të për transparencë dhe llogaridhënie për Komunën e Deçanit;
- Publikimi i konkurseve;
- Publikimi i thirrjeve për aplikim;
- Publikimi i ankandeve;
- Publikime të tjera sipas nevojës, kërkesave dhe interesave të komunës;
- Fillimi i procedurave për përgatitjen e Strategjisë Komunale për Komunikim;
- Planet, rregulloret dhe dokumente tjera që duhet të kalojnë në debat publik, publikohen edhe në platformën e konsultimeve publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

➤ Zyra e Prokurimit

Përshkrimi përmbledhës i kontratave të planifikuara për këtë vit fiskal 2024

Rend or i prokurimeve	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës
1	15000000-8	Furnizim me artikuj ushqimor	08.03.2024	1	Furnizim me artikuj ushqimor	Copë	1		9,999.00
2	28000000-2	Furnizim me material për mirëmbajtjen e institucioneve publike Deçan	10.01.2024	1	Furnizim me material për mirëmbajtjen e institucioneve publike Deçan	Copë	1		120,000.00
3	28000000-2	Furnizim me kurora dhe lulu për dëshmorë	20.02.2024	1	Furnizim me kurora dhe lulu për dëshmorë	Copë	1		6,000.00
4	17000000-2	Furnizim me veshmbathje dhe material tjetër tekstili	03.05.2024	1	Furnizim me veshmbathje dhe material tjetër tekstili	Copë	1		4,000.00
5	30215100-0	Furnizim me paisje elektronike	08.04.2024	1	Furnizim me paisje elektronike	Copë	1		30,000.00
6	33000000-0	Furnizim me paisjeve mjeksore	06.06.2024	1	Furnizim me paisjeve mjeksore	Copë	1		9,999.00
7	17000000-2	Furnizim me veshmbathje dhe material tjetër tekstili për QKMF	03.06.2024	1	Furnizim me veshmbathje për QKMF	Copë	1		8,000.00
8	33000000-0	Furnizim me material laboratorik-Reagenca	06.06.2024	1	Furnizim me material laboratorik-Reagenca	Copë	1		100,000.00
9	33000000-0	Furnizim me paisjeve mjeksore-Material Stomatologjik	25.04.2024	1	Furnizim me paisjeve mjeksore-Material Stomatologjik	Copë	1		8,000.00
10	33000000-0	Furnizime Mjeksore-Barna dhe material shpëzues për Emergjenc	08.05.2024	1	Furnizime Mjeksore-Barna dhe material shpëzues për Emergjenc	Copë	1		30,000.00
23	28000000-2	Furnizimi dhe blerja, si dhe vendosja e hidrantëve në 10 (dhjetë) pika në territorin e Komunës se Deçanit.	27.05.2024	1	Furnizimi dhe blerja, si dhe vendosja e hidrantëve në 10 (dhjetë) pika në territorin e Komunës se Deçanit.	Copë	10	2,500.00	25,000.00
24	28000000-2	Furnizimi dhe mirëmbajtja e aparateve për shuarjen e zjarrit për të gjitha institucionet publike.	05.06.2024	1	Furnizimi dhe mirëmbajtja e aparateve për shuarjen e zjarrit për të gjitha institucionet publike.	Copë	1		20,000.00
26	33000000-0	Blerja e filmave të Rengenit për QKMF	07.06.2024	1	Blerja e filmave të Rengenit për QKMF	Copë	1		35,000.00
27	02100000-5	Furnizim me lëndë djegëse(dru,pelet)	10.05.2024	1	Furnizim me lëndë djegëse(dru,pelet)	Copë	1		170,000.00
28	93000000-8	Shërbimi me tenda ,karrika dhe zerim për manifestime në Deçan	20.02.2024	1	Shërbimi me tenda ,karrika dhe zerim për manifestime në Deçan	Copë	1		50,000.00
34	33000000-0	Furnizim me medikamente për shtëpine e komuniteteve	05.04.2024	1	Furnizim me medikamente për shtëpine e komuniteteve	Copë	1		5,000.00
Totali i Vlerës									630,998.00

II.2) KONTRATAT PËR SHËRBIME

Rend or i prokurimeve	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës
11	93000000-8	Mirëmbajtja e paisjeve shëndetësore	06.06.2024	1	Mirëmbajtja e paisjeve shëndetësore	Copë	1		9,999.00
12	93000000-8	Servisimi i automjeteve zyrtare për institucionet publike në Deçan	15.08.2024	1	Servisimi i automjeteve zyrtare për institucionet publike në Deçan	Copë	1		120,000.00
29	93000000-8	Mirëmbajtja e E-Kioskut dhe pajisjeve tjera informative	15.02.2024	1	Mirëmbajtja e E-Kioskut dhe pajisjeve tjera informative	Copë	1		20,000.00
32	93000000-8	Mirëmbajtja dhe servisimi i fotokopjeve dhe printereve të institucioneve në Komunën e Deçanit	11.03.2024	1	Mirëmbajtja dhe servisimi i fotokopjeve dhe printereve të institucioneve në Komunën e Deçanit	Copë	1		5,000.00
33	93000000-8	Servisimi i Automjeteve	08.08.2024	1	Servisimi i Automjeteve	Copë	1		120,000.00
35	93000000-8	Transporti dhe qendriminë Durrës për stafin e Shtëpise komunitetit	10.07.2024	1	Transporti dhe qendriminë Durrës për stafin e Shtëpise komunitetit	Copë	1		3,000.00
37	93000000-8	Sigurimi i objektit të shërbimeve rezidenciale	08.10.2024	1	Sigurimi i objektit të shërbimeve rezidenciale	Copë	1		15,000.00
Totali i Vlerës									292,999.00

II.3) KONTRATAT PËR PUNË

Rend or i prokurimeve	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës
13	45000000-7	Renovimi i QKMF dhe AMF-ve në Deçan	03.05.2024	1	Renovimi i QKMF dhe AMF-ve në Deçan	Copë	1		45,000.00
14	45000000-7	Ndërtimi i kanalizimit në rrugën „Elena Gjika” dhe në qytetin e Deçanit.	05.04.2024	1	Ndërtimi i kanalizimit në rrugën „Elena Gjika” dhe në qytetin e Deçanit.	Copë	1		130,000.00
15	45000000-7	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës „Muharrem Lataj” në Deçan	15.04.2024	1	2. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës „Muharrem Lataj” në Deçan	Copë	1		250,000.00
16	45000000-7	Ndërtimi i objekteve memoriale të Dëshmorëve të Kombit në	02.05.2024	1	Ndërtimi i objekteve memoriale të Dëshmorëve	Copë	1		150,000.00

		fshatrat: Llukë e Epërme, Dranoc, Kodrali.			të Kombit në fshatrat: Llukë e Epërme, Dranoc, Kodrali.				
17	45000000-7	Zgjerimi i rrjetit elektrik ne Bjeshkën e Madhe, Faza e Dytë (II)	15.05.2024	1	Zgjerimi i rrjetit elektrik ne Bjeshkën e Madhe, Faza e Dytë (II)	Copë	1		320,000.00
18	45000000-7	Ndërtimi dhe asfaltimi ne Bjeshkën e Madhe, Faza e Dytë (II).	11.04.2024	1	Ndërtimi dhe asfaltimi ne Bjeshkën e Madhe, Faza e Dytë (II).	Copë	1		350,000.00
19	45000000-7	Ndërtimi i Sheshit të qytetit.	07.05.2024	1	Ndërtimi i Sheshit të qytetit.	Copë	1		900,000.00
20	45000000-7	Ndërtimi i objektit të ri të Komunës.	14.05.2024	1	Ndërtimi i objektit të ri të Komunës.	Copë	1		1,000,000.00
21	45000000-7	Ndërtimi dhe zgjerimi i segmentit të tretë të rrugës" Qendër".	20.05.2024	1	Ndërtimi dhe zgjerimi i segmentit të tretë të rrugës" Qendër".	Copë	1		550,000.00
22	45000000-7	Ndërtimi i Kullës Muze, te Verrat e Llukës	21.05.2024	1	Ndërtimi i Kullës Muze, te Verrat e Llukës	Copë	1		60,000.00
25	45000000-7	Renovimi i Shkollave	25.04.2024	1	Renovimi i Shkollave	Copë	1		60,000.00
Totali i Vlerës									3,815,000.00

II.4)KONKURSET E PROJEKTIMIT

Rend or i prokurimeve	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës
30	74000000-9	Konkursi i Projektimit për shtatoren At Gjergj Fishta	20.06.2024	1	Konkursi i Projektimit për shtatoren At Gjergj Fishta	Copë	1		80,000.00
31	74000000-9	Konkursi i Projektimit për shtatoren e Fetnete Ramosaj	15.05.2024	1	Konkursi i Projektimit për shtatoren e Fetnete Ramosaj	Copë	1		45,000.00
36	74000000-9	Hartimi I projekteve ideore dhe zbatuese	30.05.2024	1	Hartimi I projekteve ideore dhe zbatuese	Copë	1		120,000.00
Totali i Vlerës									245,000.00

➤ Zyra e Auditorit të Brendshëm

Ky Plan Vjetor është përpiluar në bazë të Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm për periudhën 2024 - 2026. Ky plan përkufizon fushëveprimin, objektivat, kohëzgjatjen dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit.

Detyrat e auditimit për vitin 2024 ndahen në bazë të burimeve njerëzore që ekzistojnë në NJAB.

Bazuar në Ligjin për Kontrollin e Brendshëm dhe Financat Publike Nr.06/L-021, Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, me Ligjin nr. 04/L-194 dhe me Ligjin nr. 05/L-063. Udhëzimet Administrative, Instruksionet financiare në fuqi, si dhe nevojën e Komunës për kryerjen e auditimit të brendshëm për vitin kalendarik 2024. NJAB do ta bëjë auditimin e brendshëm të bazuar në standardet ndërkombëtare më të përparuara sipas planit dhe dinamikës së paraparë.

Plani Vjetor duhet të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhe të azhurnohet sipas nevojës, në mënyrë që t'i pasqyrojë ndryshimet me rëndësi që ndodhin në organizatë apo në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, si dhe nga çdo detyrë shtesë që propozohet nga udhëheqësi i organizatës.

Çdo ndryshim i Planit Vjetor do të aprovohet nga Kryetari i Komunës, që janë në pajtushmëri me ligjin dhe rregulloret në fuqi. Në planin e Auditimit është paraparë zbutja e rreziqeve për objektivat e organizatës, të promovoj arritjen e ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit.

II. AKTIVITETET E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Me plan parashihen edhe elementet kyçe të kontrollit të brendshëm në mënyrë që menaxhmentit të lartë dhe atyre të rangut të mesëm të ju jepet një siguri për sistemet për të cilat janë përgjegjës, që të dizajnojnë, implementojnë dhe kontrollojnë punën që e kryejnë në përputhje me Ligjet dhe rregullat në fuqi.

Në vitin 2024 Njësia e Auditimit të Brendshëm i planifikon ti realizoj detyrat dhe aktivitetet në vijim, për arritjen e objektivave të përshkruara në Planin Strategjik:

Tabela nr. 1

Nr.	Objektivat strategjike 2024	Aktivitetet për arritjen e objektivave	Detyrat e DNJAB
1	Reflektimi i objektivave strategjike të Komunës në aktivitetet adekuate të AB;	Rishikimi permanent i aktiviteteve OB, duke reflektuar në objektivat strategjike të përcaktuara nga OB-ja.	Dhënia e sigurisë së arsyeshme, menaxhmentit për vlerësimin e drejt të mjedisit dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.
2	Funksionimi efikas i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimi i rrezikut, Zbatimi i ligjshmërisë;	Rishikimi, komentimi si dhe rekomandimi për mënyrat e menaxhimit, në pajtueshmëri me legjislacion.	Dhënia e sigurisë së arsyeshme për funksionalizimin e kontrolleve të brendshme ekzistuese.
3	Rishikimi i shfrytëzimit të mjeteve publike në mënyre efikase dhe efektive.	Rishikimi i vlerësimit i shfrytëzimit të mjeteve sipas objektivave, planit buxhetor dhe ligjeve.	Dhënia e sigurisë së arsyeshme për shfrytëzimin e drejtë efikas dhe sipas rregullave e të mjeteve.
4	Përcaktimi i “universit të auditimit” që përfshinë të gjitha fushat dhe aktivitetet në organizata të cilat mund t’i nënshtrohen auditimit të brendshëm;	Rishikimi i fushave/aktiviteteve OB, duke ofruar vlerësimin e rreziqeve, objektive dhe rekomandime për përmirësim.	Dhënia e sigurisë së arsyeshme menaxhmentit për vlerësimin e drejt të mjedisit dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.

5	Lidhjet në mes të sistemeve, fjala është për pikat e kontaktit ku sistemet shkëmbejnë informatat;	Rishikimi dhe vlerësimi i pasqyrave financiare të publikuara dhe përputhshmëria me ligjshmërinë për menaxhimin e rrezikut.	Dhënia e sigurisë së arsyeshme mbi qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave në pasqyrat financiare.
6	Opinionin e menaxhmentit mbi atë se cilat fusha apo faktor të veçantë konsiderohen si me rrezikun më të madh, etj.	Rishikimi i aktiviteteve që të vlerësohen fushat me rrezikshmëri më të lartë. Vlerësimi i shkallës së rrezikut sipas rëndësisë dhe analiza e kësaj shkalle.	Dhënia e sigurisë së arsyeshme për efikasitetin dhe efektshmërinë e procesit për menaxhimin e rrezikut.

III. DETYRAT E AUDITIMIT

Radhitja e detyrave dhe kohës efektive të planifikuar për auditim për planin vjetor 2024 dhe planin strategjik të auditimit janë si vijon;

Tabela nr. 2

N r	Njësitë e synuara të auditimit	Treguesi i rrezikut	Prioritizimi	Numri i detyrave për 2023	Nr. i ditëve të punës për person sipas strategjisë
	1	2	3	4	5
1	Te hyrat dhe te arkëtueshmet	I mesëm	2	1	20
2	Menaxhimi i personelit	I mesëm	2	2	20
3	Shpenzimet nga te gjitha kategoritë	I lartë	3	3	30
4	Procedurat e prokurimit	I lartë	3	4	30
5	Menaxhimi i kontratave	I lartë	3	5	30

6	Shpenzimet nga te gjitha kategoritë	I lartë	3	6	30
7	Auditime sipas kërkeses		1	7	10
Totali për detyrat në pajtim me vlerësimin e rrezikut dhe Strategjinë e Auditimit				6	170
Përcjellja e rekomandimeve				0	10
Detyrat për shërbime të konsulencës				0	10
Detyrat e auditimit që janë duke u zhvilluar					0
Puna tjetër e auditimit				0	0
Hetimet e mashtrimit					0
Numri i përgjithshëm i ditëve për aktivitetet e auditimit të brendshëm për NJAB					190

3.1. Detyrat e pa zbatuara nga viti i kaluar

Për vitin e kaluar kanë qenë të planifikuara 5 auditime.
Te gjitha auditimet kanë qenë me karakter sigurie dhe janë përfunduar.

3.2. Objektivat e auditimit dhe objektivat e kontrollit për vitin 2024

Gjatë përpilimit të këtij plani vjetor i kemi analizuar rreziqet dhe faktorët që ndikojnë në këto rreziqe për sistemet të cilët janë të mundshme të ndodhin gjatë rrugës për arritjen e objektivave në tërësi.

Objektiva e AB është t'i raportojë në mënyrë të pavarur menaxhmentit mbi përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme për një përdorim të duhur ekonomik, efikas dhe të efektshëm (3 E-ja) të burimeve.

Objektivë e KB-së janë:

- Parandalimi dhe zbulimi i gabimeve, parregullsive, shkeljeve ligjore dhe përcaktimin e masave për korrigjimin e tyre.
- Ruajtja dhe përdorimi i burimeve financiare, materiale e njerëzore me synim rritjen e frytshmërisë së tyre.
- Pajtueshmëria e veprimeve me rregullat dhe të rezultateve me programet e parashikuara.
- Saktësia dhe plotësia e informacionit financiar e të drejtimit si dhe përdorimin e tyre në procesin e vendimmarrjes.

3.3. Llojet e detyrave të auditimit

Pas analizës së bërë sistemeve nga AB në Deçan janë përzgjedhur detyrat me rrezikshmëri të lartë për vitin 2024 sipas shkallës së rrezikut.

Përveç detyrave të planifikuara janë përcaktuar edhe objektivat, fushëveprimi dhe periudha kohore si dhe indeksi i rrezikshmërisë. Prioritetet për kryerjen e këtyre auditimeve janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Tabela nr. 3

Nr.	Njësia e synuar e auditimit	Indeksi i rrezikut	Prioriteti	E planifikuar për vitin	Nr. i detyrës së auditimit
A	B	C	D	E	F
1	Te hyrat dhe te arkëtueshmet	2.00	Mesëm	2024	DSHS1801
2	Menaxhimi i personelit	2.00	Mesëm	2024	DSHS1802
3	Shpenzimet nga te gjitha kategoritë	2.85	I lartë	2024	DSHS1803
4	Procedurat e prokurimit	2.80	I lartë	2024	DSHS1804
5	Menaxhimi i kontratave	2.85	I lartë	2024	DSHS1805
6	Shpenzimet nga te gjitha kategoritë	2.85	I lartë	2024	DSHS1806
7	Auditime sipas kërkeses	1.70	I Ulet	2024	DSHS1807

Tabela nr. 4

Indeksi i rrezikut	Lloji i detyrës	Njësia strukturore	Objektivi i detyrës	Fushëveprimi i detyrës	Periudha
2.00	DSHS 1801	Donacionet, subvencionet dhe transferet	A zbatohen rregullat e thesarit dhe rregullorja komunale për ndarje të subvencioneve	Rishikimi i të gjitha shpenzimeve për subvencionet nga kërkesa e deri te realizimi si dhe shpenzimet e donacioneve të dhëna nga donatorët e ndryshëm.	Janar - Mars 2024
2.00	DSHS 1802	Pasuritë jofinanciare	Dhënia e sigurisë se arsyeshme të procedurave mbi inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve	Rishikimi i procedurave të regjistrimit dhe vlerësimit të pasurisë financiare dhe jo financiare për vitin 2023/2024 dhe periudha deri kur fillojmë me procedurat e auditimit.	Mars - Maj 2024
2.85	DSHS 1803	Menaxhimi i kontratave	Menaxhimi i kontratave sipas kërkesave ligjore në mënyrë të ofrimit ofrimit të sigurisë drejt arritjes së objektivave	Rishikimi i procedurave të prokurimit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2024 dhe periudha deri kur të fillojnë procedurat e auditimit duke filluar nga kërkesa për inicime e deri te nënshkrimi i kontratës si dhe mbikëqyrja e zbatimit të kontratës nga Operatori Ekonomik.	Qershor - Gusht 2024
2.80	DSHS 1804	Të hyrat dhe shpenzimet nga të gjitha kategoritë	Dhënia e Sigurisë së Arsyeshme të lidhur me shpenzimet	Rishikimi i procedurave të shpenzimeve nga të gjitha kategoritë ekonomike dhe periudhën deri kur të fillojnë procedurat e auditimit dhe gjithashtu inkasomi në baze të planifikimit të të hyrave.	Gusht - Shtator 2024
2.85	DSHS 1805	Procedurat e prokurimit	Dhënia e sigurisë së arsyeshme mbi procedurat e Prokurimit	Rishikimi i procedurave të prokurimit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2024 dhe periudha deri kur të fillojnë procedurat e auditimit duke filluar nga kërkesa për inicime e deri te nënshkrimi i kontratës si	Tetor - Nëntor 2024

				dhe mbikëqyrja e zbatimit të kontratës nga Operatori Ekonomik.	
2.85	DSHS 1807	Shpenzimet nga të gjitha kategoritë .	Dhënia e Sigurisë së Arsyeshme të lidhur me shpenzimet .	Rishikimi i procedurave të shpenzimeve nga të gjitha kategoritë ekonomike dhe periudhën deri kur të fillojnë procedurat e auditimit.	Nëntor –Dhjetor 2024

Përveç detyrave të planifikuara janë përcaktuar edhe objektivat, fushëveprimi dhe periudha kohore si dhe indeksi i rrezikshmërisë. Prioritetet për kryerjen e këtyre auditimeve janë të paraqitura në tabelën e lartshënuar.

Të gjitha aktivitetet dhe detyrat e punës të lartshënuara parashihen që Zyra e Auditimit të Brendshëm i Komunës së Deçanit t'i realizojnë sipas afateve të përcaktuara në Planin Vjetor, përveç ndonjë ndryshimi të paraqitur nga NJQHAB.

➤ Zyra e Personelit

Parashikimi i pozitave të reja

Emri i strukture organizative psh, departamenti, drejtorati, divizioni, sektori...	Kategoria funksionale	Titulli aktual i pozitës sipas standardizuar Katalogut	Grupi profesional	Klasa	Koeficienti i vjetër	Te parashikuar të lira të mbuluar nga me buxhet	Nr. i nënveçit të plotësuar kushtet për pensionim	Nr. në teprice	Kodi i programit dhe nënprogramit buxhetor i strukture organizative	Shpjegimi
Sektori për Administratë të përgjithshme		Asistent Administrativ/Receptionist	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm		3.76	0	1	0	631	Pensionim me datë: 01.12.2024
		Total	Total			0	1	0		

	Total					0	1	0		
Zyra e Kryetarit	Nivel profesional	Zyrtar Administrativ	Specialistë i Administrit të Përgjithshëm	Profesional 3	3.92	1	0	0	631	Pozitë e lirë e parashikuar me mjete buxhetore
		Total	Total			1	0	0		
	Total					1	0	0		
Zyra e Personelit	Nivel i ult udheheqes	Menaxher i Personelit	Specialistë Ligjor	Drejtuës i Ulët	7.22	0	1	0	631	Pensionim me datë: 15.03.2024
		Total	Total			0	1	0		
	Total					0	1	0		
Njësia e Auditimit të Brendshëm	Nivel profesional	Auditor i Brendshëm	Specialistë të Auditimit të Brendshëm	Profesional 1	6	1	0	0	631	Pozite e lire e mbuluar me mjete buxhtore
		Total	Total			1	0	0		
	Total					1	0	0		
Zyra e Avokatit Publik	Nivel profesional	Avokat Shtetëror	Specialistë Ligjor	Profesional 1	7.5	0	1	0	631	Pensionim me datë: 07.05.2024
		Total	Total			0	1	0		
	Total					0	1	0		
Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Nivel i ult udheheqes	Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës	Drejtuës i Ulët	7.22	0	1	0	631	Pensionim me datë: 01.10.2024

		Total	Total			0	1	0		
	Total					0	1	0		

Sektori për Buxhet- Thesar		Zyrtar Çertifikues	Specialistë Financiar		5.62	1	0	0	631	Pozite e lire e mbuluar me mjete buxhetore
		Total	Total			1	0	0		
	Total					1	0	0		
Sektori për Financa		Zyrtar për Pranim	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm		3.92	1	0	0	631	Pozite e lire e mbuluar me mjete buxhetore
		Total	Total			1	0	0		
	Nivel i larte udheheqes	Udhëheqës i sektorit të financave	Specialistë të Ekonomisë	Drejtues i Lartë 2	7.22	1	0	0	631	Pozite e lire e mbuluar me mjete buxhetore
		Total	Total			1	0	0		
	Total					2	0	0		
Zyra e Tatimit ne Prone	Nivel profesional	Zyrtar për Mbledhje të Detyrueshme	Specialistë Ligjor	Profesional 2	4.9	1	0	0	631	Pozite e lire e parashikuar me mjete buxhetore
		Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm	Profesional 3	3.92	0	1	0	631	Pensionim me datë: 17.12.2023, mirepo per shkak te ndryshimit te ligjit per zyrtaret publike baret per vitin 2024
		Total	Total			1	1	0		
	Total					1	1	0		
Sektori për Ekonomi	Nivel i ult udheheqes	Udhëheqës i Sektorit të Ekonomisë dhe Turizmit	Specialistë të Ekonomisë	Drejtues i Ulët	7.22	0	1	0	631	Pensionim me datë: 19.05.2024

		Total	Total			0	1	0		
	Total					0	1	0		
Sektori për Gjeodezi dhe Kadastër		Zyrtar për regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe informacion kadastral	Specialistë të Gjeodezisë		4.9	0	1	0	631	Pensionim me datë: 25.05.2024
		Total	Total			0	1	0		
	Nivel i ult udheheqes	Udhëheqës i Sektorit të Gjeodezisë	Specialistë Ligjor	Drejtues i Ulët	7.22	0	1	0	631	Pensionim me datë: 12.06.2024
		Total	Total			0	1	0		
	Total					0	2	0		

Sektori për Inspektion	Nivel i ult udheheqes	Udhëheqës i Sektorit për Inspektime	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm	Drejtues i Ulët	7.22	0	1	0	631	Pensionim me datë: 16.11.2023, per shkak te ndryshimit te ligjit per zyrtaret publik bartet si pozite e lire per vitin 2024
		Total	Total			0	1	0		
	Total					0	1	0		
Sektori për Sporte	Nivel i ult udheheqes	Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Sport dhe Rini	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm	Drejtues i Ulët	7.22	0	1	0	631	Pensionim me datë: 01.11.2024
		Total	Total			0	1	0		
	Total					0	1	0		
Sektori për Mirëqenie Sociale	Nivel profesional	Zyrtar për Shërbime Sociale 1	Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale	Profesional 3	3.92	0	1	0	631	Pensionim me datë: 20.09.2024
		Total	Total			0	1	0		
	Total					0	1	0		
Sektori për Mbrojtje të Mjedisit		Udhëheqës i Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm		7.22	0	1	0	631	Pensionim me datë: 23.07.2024
		Total	Total			0	1	0		
	Total					0	1	0		
Total						6	12	0		

TOTALI I PERGJITHSHEM	Kategoria funksionale	Te parashikuara te lira te mbuluara me buxhet	Nr. i nc te cilit i plotesojne kushtet per pensionim	Nr. n teprice	Shpjegimi
		2	3	0	
	Nivel profesional	3	3	0	
	Nivel i ult udheheqes	0	6	0	

	Nivel i larte udheheges	1	0	0	
	Totali i pergjithshem	6	12	0	

Mënyra e përmbushjes së planifikimit

Titulli i vendit te punes	Nr. i posteve	Propozim për group të veqantë	Lloji i procedurës për sigurim e stafit (transferim, avancim, trajnim dhe zhvillim, punesim i jashtem)	Data e synuar per plotesimin e pozitës	Kosto shtese ne page qe mund te shkaktohet
Zyrtar për Shërbime Sociale 1	1	jo	Pranim	01/04/2024	0.00
Total	1				0.00
Menaxher i Personelit	1	Specialist ligjor	Pranim	01/05/2024	0.00
Total	1				0.00
Avokat Shtetëror	1	Specialit ligjor	Pranim	01/07/2024	0.00
Total	1				0.00
Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	1	Specialist te ekonomise	Pranim	01/07/2024	0.00
Total	1				0.00

Zyrtar për regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe informacion kadastral	1	Specialist te gjeodezise	Pranim	01/08/2024	0.00
Total	1				0.00
Udhëheqës i Sektorit të Gjeodezisë	1	Specialist ligjor	Pranim	01/08/2024	0.00
Total	1				0.00
Udhëheqës i Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit	1	Specialit i mjedisit	Pranim	01/09/2024	0.00
Total	1				0.00
Udhëheqës i Sektorit të Ekonomisë dhe Turizmit	1	Specialit i bujqesise	Pranim	01/12/2024	0.00
Total	1				0.00
Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Sport dhe Rini	1	Specialist i administrimit te pergjithshem	Pranim	01/12/2024	0.00
Total	1				0.00
Asistent Administrativ/Recepionist	1	Specialit te administrimit te pergjithshem	Pranim	31/12/2024	0.00
Total	1				0.00
Udhëheqës i Sektorit për Inspektive	1	Specialist i administrimit te pergjithshem	Pranim	01/02/2024	0.00

Total	1			0.00
-------	---	--	--	------

Plani vjetor i trajnimeve

Titulli pozites per te cilen neovitet trajnim	Numri i nepunesve civil qe kane nevojë per trajnim	Kursi/titulli i programit/trajnit per stafin e punesuar	Kursi/titulli i programit/trajnimet hyrese per stafin e ri i cili parashihet te rekrutohet	Arsyetimi pse nevojitet ky trajnim
Zyrtar për Shërbime Sociale 1	1	Sherbime sociale		trajnim per pergaditje te stafit
Menaxher i Personelit	1	menaxhim i resurseve njerezore		Trajnim per pergaditje te stafit
Avokat Shtetëror	1	Legjislacion		Trajnim per pergaditje te stafit
Udhëheqës i Sektorit të Ekonomisë dhe Turizmit	1	Turizem		Trajnim per pergaditje te stafit
Zyrtar për regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe informacion kadastral	1	Prona		Trajnim per pergaditje te stafit
Udhëheqës i Sektorit të Gjeodezisë	1	Gjeodezi		Trajnim per pergaditje te stafit
Udhëheqës i Sektorit për Mbrojtë të Mjedisit	1	Mjedis		Trajnim per pergaditje te stafit
Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	1	Bujqesi dhe turizem		Trajnim per pergaditje te stafit

Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Sport dhe Rini	1	Kulture dhe sport		Trajnim per pergaditje te stafit
Asistent Administrativ/Recepionist	1	Sherbime		Trajnim per pergaditje te stafit
Udhëheqës i Sektorit për Inspektime	1	Inpektim dhe legjislacion		Trajnim per pergaditje te stafit
Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme	1	Tatimi ne prone		Trajnim per pergaditje te stafit
Zyrtar Çertifikues	1	Legjislacion		Trajnim per pergaditje te stafit
Zyrtar Administrativ	1	Legjislacion		Trajnim per pergaditje te stafit
Zyrtar për Pranim	1	Legjislacion		Trajnim per pergaditje te stafit
Auditor i Brendshëm	1	Legjislacion		Trajnim per pergaditje te stafit
Zyrtar për Mbledhje të Detyrueshme	1	Prona		Trajnim per pergaditje te stafit

➤ Drejtoria e Administratës

Duke u bazuar në organizimin e punëve dhe përgjegjësi në Drejtorinë për Administratë planifikojmë që shërbimet të funksionojnë gjatë gjithë vitit 2024 pa ndërprerje.

Organizimi i punës bëhet përmes sektorëve dhe zyrave të ndryshme:

- Sektori i qendrës për shërbim me qytetarë (QSHQ)
- Sektori i gjendjes civile
- Sektori i mirëmbajtjes dhe sigurisë së objekteve komunale
- Zyra për punë të Kuvendit
- Zyra ligjore
- Zyra për teknologji informative (IT)
- Zyra për furnizime
- Zyra për përkthime
- Zyra për përpilimin e Aktit të Vdekjes
- Shtëpiaku (Mirëmbajtësi i objekteve)

Sektori për shërbim me qytetarë - përmes këtij shërbimi bëhet pranimi dhe skanimi i çdo kërkesë të qytetarëve, po ashtu kërkesave të drejtorive dhe institucioneve të ndryshme. Të gjitha këto kërkesa marrin numrin identifikues të protokollit dhe njëkohësisht nga postë-shpërndarësi dërgohen nëpër Drejtoritë për trajtime të mëtutjeshme.

Për funksionimin e këtij sektori jemi kujdesur me furnizime të nevojshme nga kategoria mallra dhe shërbime që të përmbushen objektivat pa ndërprerje gjatë gjithë vitit. Gjithashtu jemi kujdesur edhe në planifikimet e pushimeve të punëtorëve që shërbimi të mos ketë ngecje në asnjë periudhë kohore, si atëherë kur ka fluks të ardhjes së bashkatdhetarëve.

Sektori i gjendjes civile funksionon përmes zyrave të vendit: Deçan, Irzniq, Dranoc dhe Stelc i Epërm. Për funksionimin e këtij sektori jemi kujdesur me kohë që të bëjmë furnizimin e nevojshëm vjetor me certifikata në mënyrë që palët të pajisen me shërbimin e kërkuar. Po ashtu në planifikimet buxhetore kemi planifikuar buxhet të mjaftueshëm për të gjitha nevojat e shërbimit të gjendjes civile.

Gjithashtu edhe në këtë sektor kemi harmonizuar kohën e pushimeve vjetore në mënyrë që gjatë muajve të verës kur është fluksi nga bashkatdhetarët të mos mungoj shërbimi.

Zyra për punë të Kuvendit kujdeset për përmbushjen e planit të punës së Kuvendit dhe planin e punës së Ekzekutivit Komunal. Kjo zyrë bënë përgatitjen dhe harmonizimin e materialeve në mes të legjislativit dhe ekzekutivit të cilat iu nënshtrohen trajtimeve për miratim në Kuvend. Gjithashtu kjo zyrë përgatit edhe materialet e komiteteve obligative. Përmes kësaj zyre-je mbahen të gjitha procesverbalet dhe materialet të cilat aprovohen nga kuvendi dhe ekzekutivi.

Kjo zyrë mbanë kontakte të rregullta me nivelin qendror rreth monitorimit të seancave të kuvendit, dërgon materialet për konfirmim të ligjshmërisë, gjithashtu pret konfirmimin e ligjshmërisë nga monitoruesit e nivelit qendror.

Edhe kjo zyrë furnizohet me materialet e nevojshme nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Zyra për teknologji informative (IT) - kjo zyrë menaxhon dhe mirëmban teknologjinë informative të Komunës dhe ndihmon zyrtarët në përdorimin dhe komunikimin elektronik – E-Qeverisje. Ndihmon në funksionimin e aplikacioneve të ndryshme si: Intraneti, E-pasuria, aplikacionin e Gjendjes civile, Ueb faqen zyrtare etj. Mirëmban rrjetin e Internetit dhe Intranetit brenda objektit të komunës.

Mirëmban Softuerët aplikativ dhe kujdeset për trendin e avancimit të softuerëve operativ dhe aplikativ brenda objektit të komunës.

Sektori për mirëmbajtje dhe siguri të objekteve komunale - disa shërbime në këtë sektor kryhen përmes kompanive të kontraktuara përmes procedurave të prokurimit si: Pastrimi i hapësirave brenda objekteve komunale, mirëmbajtjen e kaldajave për ngrohje, mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike etj.

Në kuadër të këtij sektori funksionon shërbimi i Rojave të Objekteve Komunale përmes orarit të caktuar të shërbimit.

Edhe me këtë shërbim kemi harmonizuar orarin e pushimeve vjetore në atë mënyrë që të mos mungoj shërbimi asnjëherë.

Zyra e furnizimit (logjistikë) funksionon përmes dy aplikacioneve E-pasuria dhe Free-balance. Në E-Pasuria bëhet pranimi dhe regjistrimi i faturave në vlerë nën 1000 euro dhe regjistrimi i inventarizimit. Ndërsa në Free-balance bëhet lëshimi i raporteve të pranimit të mallit.

Shtëpiaku kujdeset për mirëmbajtjen dhe rregullimin e çdo havarije brenda objekteve të Komunës, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta përreth objekteve komunale si dhe kujdeset për funksionimin e gjeneratorit që furnizon me rrymë elektrike në raste të ndërprerjes së rrymës.

Këtë vit planifikojmë ndarjen e 8000 euro mjete për blerjen e kompjuterëve të ri për disa shërbime të Administratës, gjithashtu 2000 euro zotime për furnizime me certifikata origjinale. Të gjitha këto mjete shpenzohen nga kategoria për mallra dhe shërbime. Furnizimet tjera bëhen sipas kërkesave dhe kontratave të themeluara nga zyra e prokurimit.

Kujdes do të bëjmë në zvogëlimin e shpenzimeve nga kategoria për mallra dhe shërbime.

Do angazhohemi në përmbushjen dhe realizimin e të gjitha objektivave që dalin nga përgjegjësitë tona si Drejtori.

➤ **Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit**

Puna në Drejtorinë tone zhvillohet rreth kërkesave të qytetareve për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje legalizimi, nevojave të komunës për zhvillim të projekteve të reja, përpilimit të paramasave për renovimin e objekteve komunale, mirëmbajtja dhe përditësimi i sistemit të adresave etj. dhe bazohet kryesisht në Ligjin Për Ndërtim 04/L-110, Ligji Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen E Mjedisit, Ligji Nr.05 L-31 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 06/L-024 Për Trajtimin E Ndërtimeve Pa Leje dhe aktet nën ligjore që rrjedhin prej tyre dhe në rregulloret komunale.

Tabela e aktiviteteve

Nr.	Aktiviteti	Spektori	Periudha
1	Organizimi i aktiviteteve dhe detyrave të punës në kuadër të stafit të Drejtorisë së Urbanizmit	Drejtori Shefi	Janar - Dhjetor
2	Kryerja e procedurave rreth dhënies së kushteve të lokacionit, për ndërtimet e objekteve të reja, adaptimet, rekonstruimet, rindërtimet etj.	Spektori i urbanizmit	Janar - Dhjetor
3	Kryerja e procedurave rreth dhënies së lejes së ndërtimit, leje rrënimi, leje mjedisore	Spektori i urbanizmit	Janar - Dhjetor
4	Llogaritja e taksave urbanistike dhe atyre mjedisore	Spektori i urbanizmit	Janar - Dhjetor

5	Kryerja e procedurave rreth dhënies së lejes së përdorimit	Sektori i urbanizmit	Janar - Dhjetor
6	Kryerja e procedurave rreth dhënies së lejes së legalizimit të objekteve pa leje	Sektori i urbanizmit	Janar - Dhjetor
7	Përgatitja dhe kompletimi i aplikacioneve për përfitimin e buxheteve për projektet e ndryshme, MAPL, MZHE, MPHMMI, MZHR, MK, MF etj.	Sektori i planifikimit	Janar - Dhjetor
8	Përgatitja e vendimeve dhe pëlqimeve për mbështetjen për të interesuarit për investime në komunën tonë	Sektori i urbanizmit	Janar - Dhjetor
9	Puna në komisionet për vlerësimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për leje të përdorimit	Sektori i urbanizmit	Janar - Dhjetor
10	Angazhimi i drejtorisë për informimin e qytetareve për legalizimin e objekteve pa leje përmes ueb faqeve dhe tabelave informuese	Drejtoria	Janar - Dhjetor
11	Organizimi i Shqyrtimit Publik të PZHK-se	Sektori i planifikimit	Mars - Prill
12	Hartimi i HZ sipas udhëzimeve administrative dhe ligjit të planifikimit	Sektori i planifikimit	Qershor - Dhjetor
13	Puna dhe pjesëmarrja në hartimin e Planit të Hollësishëm të Detajuar	Sektori i planifikimit	
14	Puna dhe Menaxhimi i planeve rregulluese të hollësishme për: Bjeshkën e Belegut, Dervishkomin dhe Lakun e Kryqës	Sektori i planifikimit	Janar - Dhjetor
15	Organizimi i konkursit për Shtatoren e At Gjergj Fishtes	Drejtoria	Korrik
16	Organizimi i konkursit për Shtatoren e Fitnete Ramosaj	Drejtoria	Qershor
17	Puna në komisione vlerësuese për projekte të ndryshme	Drejtoria	Janar - Dhjetor

Mbikëqyrja e punimeve për projektet në vazhdim

1	Projekti i shtratit të Lumit të Lumbardhit të Deçanit
2	Meremetimi dhe inventarizimi i objektit shtëpia alpine bjeshkatore “Shkelzen Haradinaj”
3	Ndërtimi i katër urave ne rrugën qe te çon ne Roshkodol dhe parkut ne Isniq
4	Asfaltimi dhe sistemimi i rrugës “Arben Qerimaj” në komunitetin ashkali në Baballoq dhe rrugës “Veteranët e UÇK” në komunitetin boshnjak në Prapaqan
5	Ndërtimi i pishinës se mbyllur olimpike
6	Ndërtimi i rrethojës ne SHMU “Ardhmeria” Beleg”
7	Projekti i ndërtimit te fshatit turistik Podi i Gështenjave.
8	Projekti i Ndërtimit dhe Riparimit te Memorialëve te Dëshmorëve
9	Projekti i elektrifikimit ne Bjeshke te Belegut
10	Hartimi i Hartës Zonale
11	Organizimi i debateve publike per Planin Zhvillimor Komunal
12	Renovimi i QKMF “Adem Ukehaxhaj”
13	Te tjera projekte qe do te fillojnë ne kete vit

Përgatitja e paramasës për shërbimet për hartimin e projekteve për vitin 2024 dhe menaxhimi i tyre gjatë projektimit duke u bazuar në buxhetin e vitit 2024

Nr	Emertimi i projektit
1	Projekti Kryesor dhe Zbatues për rrugë Urbane
2	Projekti Kryesor dhe Zbatues për rrugë Lokale.
3	Projekti Kryesor dhe Zbatues për Sheshe dhe Memoriale të Dëshmorëve.
4	Projektit Kryesor dhe zbatues me inçizim gjeodezik për rrugët në Bjeshkët e Komunës së Deçanit.
5	Projekti Kryesor dhe Zbatues për ujësjellës
6	Projekti Kryesor dhe Zbatues për kanale të ujitjes
7	Kryerja e detyrave të ndryshme të dhëna nga drejtori dhe Kryetari i Komunës.
8	Inçizimi gjeodezik dhe përcaktimi i kufijve të pronave Komunale në prona private
9	Raportet gjeodezike për hapësirat zhvillimore me interes të përgjithshëm
10	Hartimi i Projektit kryesor Ndertimi i kompleksit memorial për të gjithë dëshmoret e kombit në komunën e Decanit
11	Hartimi i Projekteve për shtegun e biciklisteve
12	Hartimi i Projekteve për Elektrifikimin për vendbanimin Pleqe
13	Hartimi i Projekteve të ndryshme sipas nevojës

➤ **Drejtoria për Buxhet dhe Financa**

Plani i punës për vitin 2024 i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa do të jetë në harmoni të plotë me planet e punës së Qeverisë Komunale, duke pasur parasysh respektimin e plotë të Ligjeve dhe rregulloreve që e rregullojnë punën mjaft delikate të kësaj drejtorie siq janë:

- Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligjin mbi financa të pushtetit lokal;
- Ligjin mbi vetqeverisjen lokale;
- Urdhëresat Administrative;
- Rregulloret financiare të MF-it gjegjësisht Departamentit të Buxhetit dhe Thesarit;

Drejtoria për Buxhet dhe Financa funksionon në dy sektore:

1. Sektori i Buxhetit dhe Financave ku është e inkuadruar edhe zyra e të hyrave
2. Sektori i Tatimit në Pronë

Sektori i Buxhetit dhe Financave

Në sektorin për Buxhet dhe Financa gjatë vitit 2024 planifikojmë këto aktivitete:

- Përgatitja e planit për zotimin-shpenzimin e buxhetit (rrjedha e parasë) viti 2024 për të gjitha programet buxhetore;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave buxhetore të vitit 2023 - Pasqyrat financiare;
- Përgatitja e raportit janar-dhjetor e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore 2023;
- Bartja e mjeteve të mbetura të pashpenzuara nga viti 2023 (të hyrat vetanake) për shpenzim në vitin 2024 me vendim të Asamblesë Komunale;
- Raportimi i faturave të pa paguara për të gjitha programet;
- Zotimi i mjeteve të alokuara për programe dhe kategori ekonomike;
- Regjistrimi i shpenzimeve sipas modulit të aprovimit dhe blerjes/B.K;
- Regjistrimi i të gjitha parave të imta dhe avanseve;

- Certifikimi dhe Aprovimi i të gjitha pagesave në nivel komunal;
- Barazimi mujor i shpenzimeve në sistemin FB;
- Rishikimi buxhetor gjashtëmujor 2024 (nëse MF e parasheh me UA);
- Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore të mjeteve sipas dinamikës së paraparë për vitin fiskal 2024;
- Ndhmon në rregullimet e buxhetit përmes ridestinineve dhe transfereve brenda programit buxhetor dhe programeve brenda OB;
- Përgatitja e KAB-it komunal 2025-2027;
- Planifikimi i buxhetit për vitin 2025 konform Qarkoreve buxhetore nga MF-i si dhe udhëzimeve tjera. 15. Rgjistrimi i të dhënave buxhetore në sistemin BDMS;
Qëllimi parësorë i punës së stafit të Drejtorisë do të jetë rritja e efikasitetit dhe të transparencës si dhe forcimi i besimit të qytetarëve dhe subjekteve afariste në qeverisjen komunale.

Inspektorët përkatës përmes mbikëqyrjes inspektuese bëjnë zgjidhjen e çështjeve administrative si organ i shkallës së parë.

Ligjet dhe aktet nënligjore sipas fushë veprimtarive, por duke mos përjashtuar edhe orientimet strategjike të Ekzekutivit Komunal, do të jenë norma mbështetëse e punës së inspektorëve sipas lëmive përkatëse.

Plani vjetor i mbikëqyrjes inspektuese përmban një pasqyrë të përgjithshme të punëve dhe detyrave të inspektorëve komunal për vitin 2024, në implementimin e drejtpërdrejtë të ligjeve, akteve tjera nënligjore, rregulloreve dhe vendimeve komunale si dhe përcjelljes së gjendjes në territorin e Komunës së Deçanit nga fushe veprimtaria e secilit inspektor komunal.

Inspektimet e rregullta do të kryhen çdo ditë sipas planit të inspektoreve, kurse sipas nevojë dhe kërkesave të paraqitura, kryhen edhe inspektime të jashtëzakonshme.

Në raste të caktuara do të kryhen edhe inspektime plotësuese dhe kontrolluese me qëllim të përcjelljes së plotësimin të rekomandimeve paraprahe të inspektorëve.

Inspektimet e pa planifikuara do të insistohet që të kryhen të njëjtën ditë të parashtrimit të kërkesës së qytetarit, subjektit apo të ndonjë organi tjetër me qëllim të parandalimit të dukurisë e cila bie ndesh me ligjet dhe aktet tjera normativa nga lëmi përkatës.

Inspektorët përparësi do të ju japin vizitave këshillëdhënëse, ku subjektet e mbikëqyrura do të njoftohen me dispozitat ligjore përkatëse, plotësimet dhe ndryshimet eventuale të tyre dhe do ju japin këshilla profesionale si masë parandaluese, duke mos përjashtuar lëshuarjën e aktvendimeve për ndalimin e aktiviteteve jashtë ligjore apo edhe ndërmarrjen e veprimeve ndëshkimore në harmoni me Ligjet përkatëse.

Në kuadër të Drejtoratit veprojnë këta Inspektor:

- Inspektori i tregut;
- Inspektori i mbrojtjes së ambientit;
- Inspektori i Ndërtimit (i angazhuar me kontrate me kontratë mbi shërbimet e veçanta);
- Inspektori i veterinarisë (i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta).

Përveç punëve dhe detyrave të punëve sipas ligjeve dhe akteve tjera nënligjore përkatëse të përcaktuara për Inspektorët Komunal, të njëjtit do të bashkëpunojnë ngushtë edhe me inspektorët e nivelit qendror nga Ministrit e linjës.

Detyrë parësore e inspektorëve do të jetë që në afatin më të shkurt të mundshëm do të ju përgjigjen kërkesave të qytetarëve dhe organeve qendrore dhe komunale.

Për të njëjtat do të mbajnë evidencë zyrtare, do të ju përgjigjen palëve dhe do të raportojnë në organet përkatëse.

Gjate vitit 2024 Drejtorati për Inspekcione, gjegjësisht inspektorët sipas fushe veprimtarive përkatëse kryesisht do të zhvillojnë aktivitetet si vijon:

Aktiviteti	Koha	Bartësi
Koordinimi i aktiviteteve ndër-inspektoriale (tregut, ndërtimit, mjedisit, veterinës).	Çdo fillim jave.	Të gjithë inspektorët
Kontrollimi i produkteve për tregtim të artikujve ushqimor dhe jo-ushqimor, theksimi i çmimeve të mallrave të dedikuara për treg.	Së paku njëherë në muaj dhe sipas ankesave të konsumatorëve	Inspektori i Tregut
Mbikëqyrje parandalim të ndotjes mjedisore nga substancat kontaminuese /rrezikshme, me ndikim të rrezikshëm në tokë, ujë dhe ajër.	Në vazhdimësi dhe sipas kërkesave.	Inspektori i Ambientit
Shqyrtim i kërkesave të parashtruara nga personat fizike dhe juridike.	Në vazhdimësi sipas kërkesave të arritura.	Secili inspektor sipas fushveprimtarisë.

Kontrollimi i përmbajtjes se orarit të punës sipas Rregullores komunale Zbatim i Rregullores Komunale mbi plotësimin e kushteve minimale teknike dhe sanitare nga aspekti i hapësirave punuese si dhe pajisjeve dhe stabilimenteve për punë.	Së paku njëherë në muaj dhe sipas kërkesave dhe ankesave Në vazhdimësi varësisht nga kërkesat	Inspektori i Tregut Inspektori i tregut dhe i ambientit.
Inspektim dhe rregullimi i tregut të gjelbër. Inspektimi i objekteve ndërtimore pas njoftimit të organit kompetent për dhënien e lejes ndërtimore lidhur me zbatimin e lejes (në fillim dhe përfundim të punimeve) Inspektimi në teren për ndërtimet pa leje dhe ndërmarrja e masave parandaluese,	Njëherë në javë ditën e tregut Sipas nevojës E vazhdueshme	Inspektori i tregut Inspektori i Ndërtimit Inspektori i Ndërtimit

Mbikëqyrje aktiviteteve më ndikim negativë në mjedis si dhe mundësitë e parandalimit të tyre.	E vazhdueshme	Inspektori i Ambientit
Kontrolle/mbikëqyrje pjesës urbane dhe rurale për mbrojtje të mjedisit nga hedhja e mbeturinave amvisërisë dhe mbeturinave inerte.	E vazhdueshme	Inspektori i Ambientit
Mbikëqyrja inspektuese e subjekteve ekonomike që me veprimtarin e tyre gjenerojnë mbeturina inerte të pa rrezikshme.	E vazhdueshme	Inspektori i Ambientit
Mbikëqyrja inspektuese e operatorëve që posedojnë leje për operim me mbeturina të pa rrezikshme dhe e operatorëve qe veprimtarin e kryejnë pa leje përkatëse.	E vazhdueshme	Inspektori i Ambientit
Mbikëqyrja e inspektuese e ndotësve të ujit, ajrit etj.		
Identifikimi i deponive ilegale dhe propozimi i masave për eliminimin e tyre	Prill	Inspektori i Ambientit
Hartimi i raporteve mujore të punës nga secili inspektor sipas lëmisë përkatëse,	Në fillim të çdo muaji për muajin paraprak	Të gjithë Inspektorët

Këto janë në parim aktivitetet e rregullta të Drejtorisë për vitin 2024 dhe tjera që do të imponohen nga kërkesat qoftë të palëve apo organeve tjera ligje zbatuese. Secili nga inspektorët do të hartoj plan-detaj të aktivitetit të mbikëqyrjes inspektuese.

➤ **Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim**

Ndërsa hyjmë në vitin 2024, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Deçanit është e angazhuar të përmbush një varg objektivash ambicioze dhe të qëndrueshme, te përqëndruara në zhvillimin e turizmit dhe nxitjen e vlerave natyrore të rajonit tonë. Me këtë Plan të Punës, ne synojmë të vendosim Deçanin si një qendër të njohur për turizmin natyror dhe kulturor duke shtuar vlerë jo vetëm për ekonominë lokale, por edhe për jetën e komunitetit.

Përfituesit përfundimtar të Planit të Punës:

Përfituesit përfundimtar të Planit të Punës janë qytetarët e Komunës së Deçanit, pronarët e bizneseve prodhuese dhe tregtare, pronarët e hoteleve dhe bujtinave, organizatat jo-qeveritare lokale dhe operatorët lokal.

Misioni i Planit të Punës

1. Krijimi i mundësive për zhvillim ekonomik dhe turistik të Komunës së Deçanit.
2. Përmbyllja e strategjive dhe Planit Zhvillimor Komunal për krijimin e kushteve për promovimin e vlerave rurale dhe malore turistike të komunës.
3. Mbështetja e bizneseve të vogla, të mesme dhe të mëdha që janë prodhuese dhe tregtare.
4. Rritja e punësimit në komunë.
5. Krijimi dhe ngritja e kapaciteteve hoteliere dhe bujtinave në zonat rurale dhe malore.

6. Ngritja e kampeve në Bjeshkët e Deçanit dhe shenjëzimi i të gjitha shtigjeve për çiklizëm dhe ecje, si dhe shtigjeve të tjera në të gjitha, tetëmbëdhjetë Bjeshkët e Deçanit.

Qëllimi i Planit të Punës

Qëllimi i Planit të Punës për vitin 2024 është të krijojë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e Komunës së Deçanit në fushën e ekonomisë dhe turizmit. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim synon të ndihmojë në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe të turizmit, përmes krijimit të kushteve të favorshme për bizneset, promovimit të vlerave natyrore dhe kulturore të komunës, dhe ngritjen e kapaciteteve turistike.

Kështu, plani synon të kontribuojë në rritjen e punësimit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës së Deçanit. Gjithashtu, qëllimi është të kujdeset për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të kësaj zone dhe të prezantojë atë për turistët vendas dhe ndërkombëtarë.

Qëllimi i Planit të Punës është për Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim të krijojë kushte të qëndrueshme për zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë në Komunën e Deçanit. Drejtoria synon të:

1. Promovojë turizmin në komunë.
2. Mbrojë dhe promovojë vlerat natyrore dhe kulturore të komunës.
3. Bashkëpunojë me organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare, ndërkombëtare.
4. Zhvillojë ekonominë dhe turizmin në komunë dhe të sigurojë financim për këto fusha.
5. Nxisë bizneset, organizatat qeveritare dhe jo qeveritare, dhe tour operatorët lokal në zhvillimin dhe promovimin e turizmit veror dhe dimëror, duke rritur numrin e turistëve në zonat rurale dhe malore.

Objektivat e Planit të Punës për vitin 2024 janë:

1. Zhvillimi ekonomik dhe social i Komunës së Deçanit.
2. Promovimi i turizmit veror dhe dimëror në komunë.
3. Ngritja e kapaciteteve turistike të komunës dhe fuqizimi i bizneseve prodhuese dhe tregtare lokale.
4. Krijimi i brendeve të ndryshme prodhuese.
5. Ruajtja dhe promovimi i vlerave natyrore, tradicionale, kulturore dhe fetare të komunës.
6. Përmirësimi i infrastrukturës turistike dhe shërbimeve për vizitorët.
7. Rritja e numrit të aktiviteteve turistike dhe ngjarjeve kulturore në komunë.

8. Përdorimi i teknologjisë për të promovuar turizmin dhe shërbimet lokale.
9. Bashkëpunimi më i ngushtë me autoritetet qendrore dhe ndërkombëtare për të mbështetur zhvillimin e turizmit.
10. Hartimi i Pakos Turistike: Planifikimi për hartimin e një pako turistike të re, duke përfshirë oferta të reja për turistët, si udhëtime aventuristike, aktivitete të natyrës, ose oferta kulturore të reja.
11. Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe mjedisit për të rritur atraktivitetin e komunës për turistët.
12. Ngritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të komunitetit dhe bizneseve në lidhje me turizmin e përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm.

AKTIVITETI	BARTESI	PERIUDHA E IMPLEMTIMIT	FONDET	REZULTATET E PRITURA	RREZIQET
1.Regjistrimi i bizneseve dhe shërbime tjera rreth kërkesave të bizneseve	DEZH ARBK	Janar 2024 Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit ARBK	-Shërbime më të mira për bizneset lokale. -Fuqizimi i bizneseve. -Mbështetja dhe informimi i bizneseve.	-Mos kryerja e dokumenteve me kohë i bizneseve. -Ligjet jo të favorshme për biznese. -Mungesa e mjeteve financiare për mbështetjen e bizneseve.
2.Panairi Veror-2024	Komuna e Deçanit, Institucionet Qendrore, Organizatrat Jo- Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare bizneset lokale, prodhuese vendore dhe të vendeve fqinje	Qershor 2024	Komuna e Deçanit	-Promovimi i produkteve vendore. -Krijimi i bashkëpunimit mes bizneseve. -Shitja dhe marketingu i bizneseve prodhuese lokale. -Promovimi i produkteve vendore.	-Mos pjesëmarrja e bizneseve në panair. -Mungesa e mjeteve financiare për organizimin e panairit.
3.Projekte kapitale për promovimin e turizmit dhe	Komuna e Deçanit DEZH	Janar 2024 Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit - Mjete Kapitale	- Promovimi i turizmit veror dhe dimëror në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar	-Mungesa e mjeteve financiare.

ngritjen e kapaciteteve turistike	Donator vendor dhe ndërkombëtar		Institucione Qendrore Organizata Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Bizneset Lokale	-Ngritja kapaciteteve turistike si në zonat rurale dhe malore. -Ngritja e kapaciteteve shërbyese me të mira për turistë. -Krijimi i mundësive për zhvillim ekonomik dhe punësim.	-Mungesa e kapaciteteve profesionale. -Mungesa e bashkëpunimit dhe tour operatorëve lokal. -Mungesa e shoqatave bjeshkatore lokale.
4.Krijimi i bashkëpunimit me pronarët e kullave, bujtinave, tour operatorëve lokal dhe rajonal, shoqatave bjeshkatore lokale dhe rajonale dhe objekteve fetare dhe krijimi i bazës së të dhënave për numrin turistëve dhe kërkesave dhe nevojave të tyre.	DEZH, Pronarët e kullave, bujtinave dhe përfaqësuesit e objekteve fetare, shoqatat bjeshkatore lokale dhe rajonale, tour operatorët lokal dhe rajonal, agjenci të ndryshme.	Janar 2024 Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit Fonde nga Organizata Jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare	-Krijimi i bazës së të dhënave për numrin e turistëve. -Bashkëpunimi me i mire mes institucioneve dhe përfaqësuesve tjerë lokal. -Shërbime me të mira për turistët. -Zhvillimi ekonomik i komunës.	-Mos bashkëpunimi i duhur i personave relevant në këto fusha. -Mos regjistrimi i turistëve gjatë vizitave të tyre në zonat rurale dhe malore. -Mungesa e mjeteve financiare dhe kapacitetet profesionale.
5.Festivali i punimeve artizanale dhe ushqimeve tradicionale	DEZH Donator Organizata Qeveritare dhe Jo-qeveritare, Prodhuesit e Punimeve Artizanale, Ushqimit etj.	Gusht 2024	Komuna e Deçanit Fonde nga Organizata Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare	-Promovimi i prodhimeve vendore me punë dore. -Mbështetja e prodhuesve artizanal (veçanërisht grave). -Ruajtja e vlerave kulturore dhe tradicionale.	-Mungesa e mjeteve financiare për organizmin e festivalit. -Kushtet klimatike. -Mos krijimi i bashkëpunimit mes institucioneve dhe

					prodhueseve te punimeve artizanale.
6.Formimi i ofertës së pakos turistike për zonat rurale dhe malore në Komunën e Deçanit.	Komuna e Deçanit DEZH Donator vendor dhe ndërkombëtar Shoqatat bjeshkatore, Tour operatorët, Ekspert të fushës së ekonomisë dhe turizmit	Janar - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit Fonde nga Organizata Jo-qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare .	-Promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore të komunës. -Shërbime me të mira turistike si në zonat rurale dhe malore. -Krijimi i pakos digjitale për promovimin e vlerave turistike. -Rritja e vizitoreve në zonat rurale dhe malore dhe ngritja e kapaciteteve mikpritëse profesionale	-Mungesa e mjeteve financiare për krijimin e ofertës turistike. -Kushtet klimatike -Mungesa e kapaciteteve profesionale dhe shoqatave lokale. -Mos informimi apo pasqyrimi jo i duhur medial dhe në rrjetet sociale.
7.Shenjëzimi i shtigjeve për ecje dhe çiklizëm dhe shtigjeve tjera në zonat rurale dhe malore në tetëmbëdhjetë bjeshkët e Komunës së Deçanit	Komuna e Deçanit DEZH Donator vendor dhe ndërkombëtar Shoqatat jeshkatore, Tour operatorët, Ekspert të fushës se ekonomisë dhe turizmit	Janar - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit DEZH Donator vendor dhe ndërkombëtar Shoqatat bjeshkatore, Tour operatorët,	-Shenjëzimi i të gjitha shtigjeve për ecje dhe çiklizëm. -Shërbime me të mira për turistë. -Informimi më i mirë për turistët.	-Mungesa e mjeteve financiare. -Kushtet klimatike. -Shkatërrimi i tabelave dhe shenjave për ecje dhe çiklizëm. -Mos publikimi në rrjete të ndryshme sociale i shtigjeve.
8.Subvencione dhe mbështetje	Komuna e Deçanit	Janar - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit	-Nxitja e të rinjëve për hapjen e bizneseve.	-Mungesa e mjeteve financiare

financiare për bizneset prodhuese, bizneset e vogla dhe të mesme	DEZH Institucionet Qeveritare dhe Ndërkombëtare Organizatat Jo-Qeveritare bizneset në Deçan		Organizata Jo-Qeveritare Vendore dhe Rajonal, Ndërkombëtare	-Mbështetje e bizneseve ekzistuese. -Fuqizimi i bizneseve lokale dhe krijimi i vendeve të reja të punës dhe zhvillimi ekonomik i komunës. -Krijimi i mundësive më të mira për punë. -Krijimi i bashkëpunimit më të mirë mes institucioneve dhe qytetarëve. -Krijimi i mundësive për bizneset lokale dhe prodhuesit vendor për pjesëmarrje në panaire të ndryshme në vende dhe jashtë vendit.	-Procedurat aplikuese. -Mos plasimi i duhur në tregun lokal dhe rajonal i prodhimeve.
09.Mbajtja e Kampit Veror për të rinjtë	Komuna e Deçanit DEZH	Gusht 2024	Komuna e Deçanit DEZH	-Promovimi i turizmit përmes kampingut një ditorë breg Lumbardhit të Deçanit. -Njoftimi me pajisjet e kampingut dhe rëndësinë e tij -Shfrytëzimi i lumit dhe bukurisë së tij. -Njoftimi me Via Ferrata si atraksion turistik	-Mos pjesëmarrja në kamping e të rinjëve -Kushtet klimatike
10.Inicimi dhe krijimi i brendit të produkteve vendore lokale (prodhimit të	Komuna e Deçanit, prodhuesit lokal, Institucionet	Janar - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit Organizata	-Promovimi i produkteve natyrore dhe tradicionale të komunës.	-Mungesa e mjeteve financiare për fuqizimin e prodhueseve.

qumështi, pemëve, mjaltes, gështenjës, ujit natyral dhe ujit mineral) etj.	vendore dhe ndërkombëtare, Ekspert të fushave të ndryshme		Jo-Qeveritare Vendore, Rajonale dhe Ndërkombëtare	-Fuqizimi i prodhueseve vendor dhe zhvillimi ekonomik i komunës. -Ruajtja e vlerave lokale dhe krijimi i mundësive për bizneset. -Bashkëpunim më i mirë me qytetarët e Komunës së Deçanit	-Mungesa e laboratorëve adekuat për cilësinë e prodhimit. -Mos plasimi i duhur në tregun lokal dhe rajonal. -Mungesa e promovimit në nivel lokal dhe ndërkombëtar.
11.Inicimi i procedurave dhe krijimi i Strategjisë Lokale të Zhvillimit Ekonomik për Komunën e Deçanit.	DEZH, Organizata Jo-Qeveritare dhe Vendore, Organizatat Ndërkombëtare, Ekspert të fushave të ndryshme	Janar - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit, Donator Vendor dhe Ndërkombëtar	-Krijimi i një plani afatgjatë për zhvillimin ekonomik. -Gjendja ekonomike dhe sociale e tanishme. -Veprimet që duhet të merren për zhvillimin ekonomik, turizmit dhe bizneseve në Deçan. -Nxitja e bashkëpunimit mes institucioneve dhe qytetarëve.	-Mungesa e përkrahjes financiare. -Mos përkrahja nga institucionet lokale dhe qendrore. -Mos zbatimi i kësaj strategjie pas hyrjes në fuqi.
12.Bashkëpunimi me institucionet qendrore, organizata ndërkombëtare, organizata jo-qeveritare dhe ndërkombëtare, me ekspert të ndryshëm dhe institucione tjera shoqërore.	DEZH, Ministritë, Organizatat Jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, Ekspert të ndryshëm, Institucione tjera shoqërore.	Janar - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit, Institucionet Qendrore dhe Organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare.	-Krijimi i bashkëpunimit më të mirë mes institucioneve. -Krijimi i kushteve më të mira sociale dhe ekonomike të qytetarëve. -Informimi i duhur i qytetarëve për çështje të ndryshme. -Zhvillimi ekonomik i komunës.	-Mos bashkëpunimi i mirë mes institucioneve. -Procedurat administrative. -Mos planifikimi i duhur buxhetor, i kohës dhe mungesa mjeteve administrative.

13. Informimi dhe mbështetje bizneseve lokale në aplikime të ndryshme për grante si në institucionet qendrore ashtu dhe ndërkombëtare	DEZH, Ministritë Organizatat vendore dhe ndërkombëtare Bizneset Lokale	Janar - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit, Institucionet Qendrore dhe Organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare.	- Informimi më i mirë i qytetarëve. - Krijimi i mundësive për ngritjen e kapaciteteve prodhuese. - Fuqizimi i bizneseve lokale. - Zhvillimin ekonomik i komunës.	- Mos informimi me kohë i bizneseve. - Mungesa e kuadrove profesionale brenda drejtorisë dhe të bizneset. - Procedurat aplikuese të vështira.
14. Funksionalizimi dhe punësimi i dy personave që njohin gjuhë të huaj dhe fushën e turizmit në Qendrën Informuese Turistike.	Komuna e Deçanit DEZH	Janar - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit, Institucionet Qendrore dhe Organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare.	- Informimi më i mirë i turistëve për vlerat natyrore dhe kulturore të komunës. - Rritja e numrit të turistëve. - Promovimi i turizmit në nivel vendor dhe ndërkombëtar.	- Mungesa e materialeve promovuese. - Mungesa e kuadrove profesionale në fushën e turizmit. - Mungesa e mjeteve buxhetore për punësimin e personave dhe mos funksionalizimi i duhur i Qendrës Informuese.
15. Projekti Zgjerimi i Via Dinarica në Rajonin Ndërkufitarë Kosovë-Shqipëri Komuna e Deçanit-	Komuna e Deçanit Qytetarët e Komunës së Deçanit Shoqata lokale të bjeshkatarëve Projekti NaturKosovo	Janar – Dhjetor 2024-2025	Komuna e Deçanit Bashkimi Evropian Komunat tjera të përfshira në këtë projekt	- Krijimi i shtigjeve të reja në zonat malore nga Kosova në Shqipëri VIA DINARICA. - Trajnime të anëtarëve shoqatave bjeshkatarë lokale. - Promovim i turizmit malor dhe materialeve tjera promovuese.	- Kushtet klimatike - Procedurat administrative. - Mos pagesa me kohë e mjeteve buxhetore nga ana e komunave.

16.Krijimi i Zyrës së Hartimit të Projekteve në kuadër të drejtorisë dhe punësimi me kohë të caktuar ose të plotë në këtë zyre.	Komuna e Deçanit, Organizata Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare	Janar - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit Institucionet Qendrore dhe Organizata Vendore dhe Ndërkombëtare	-Mbështetje qytetarëve dhe bizneseve në aplikim për projekte të ndryshme. -Hartimi i projekteve fushën e turizmit dhe zhvillimit ekonomik. -Krijimi i shërbimeve me të mira për qytetarët.	-Mungesa e mjeteve buxhetore. -Mos përkrahja nga institucionet qendrore dhe lokale për hapjen e kësaj zyrjeje.
17.Dita e Qethave	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetarët e Komunës së Deçanit Bizneset Lokale	Korrik 2024	Komuna e Deçanit DEZH Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare	-Ruajtja e vlerave natyrore dhe tradicionale të komunës. -Promovimi i turizmit malor dhe natyror. -Promovimi i ushqimit tradicional. -Fuqizimi i blegtorëve dhe pronarëve të bujtinave. -Ngritja e kapaciteteve mikpritëse të pronarëve të staneve në zonat malore. -Rritja e numrit të turistëve që vizitojnë zonat malore. -Zhvillimi ekonomik i komunës.	-Kushtet klimatike. -Mungesa e mjeteve financiare. -Mungesa e ushqimit natyral dhe blegtorëve në zonat malore. -Mungesa e bagëtive në zonat malore. -Harresa dhe mos interesim për ruajtjen e vlerave tradicionale.
18.Blerja e produkteve të turizmit	Komuna e Deçanit	Mars - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit DEZH	-Me furnizimin e Qendrës Informuese Turistike në Deçan me produkte të reja synojmë që të arrijmë në shtimin e mundësisë për përjetimin e bukurive natyrore si dhe artificiale të krijuara si atraksione	-Mungesa e fondeve për blerjen e pajisjeve -Cilësia e dobët e pajisjeve -Mos përdorimi i tyre adekuat etj.

				turistike në Komunën e Deçanit	
19.Gara e Skijimit-Kupa e Gjeravicës Bjeshka e Belegut	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetarët e Komunës së Deçanit Bizneset Lokale Ekspert të ndryshëm Tour Operator vendor dhe ndërkombëtare Federata e Skitarisë së Kosovës.	Mars 2024	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatata Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetarët e Komunës së Deçanit Bizneset Lokale Ekspert të ndryshëm Tour Operator vendor dhe ndërkombëtar Federata e Skitarisë së Kosovës.	-Promovimi i turizmit dhe sportit dimëror -Krijimi i Bjeshkës së Belegut si qendër e skitarisë. -Fuqizimi ekonomik i komunës -Gara e Skijimit-Kupa e Gjeravicës të njihet si garë nacionale dhe ndërkombëtare.	-Kushtet klimatike -Mungesa e mjeteve financiare për mbajtjen e garës dhe krijimin e qendrës së skijimit. -Mos njohja e garës në nivel nacional dhe ndërkombëtar. -Mos promovimi i garës në nivel ndërkombëtar dhe rrjete ndryshme sociale
20.Projekte infrastrukturore në fushën e ekonomisë dhe ngritjes kapaciteteve turistike	Komuna e Deçanit DEZH DUPH Institucione Vendore dhe Ndërkombëtare Organizata Jo – Qeveritare	Janar - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit DEZH DUPH Institucione Vendore dhe Ndërkombëtare Organizata Jo – Qeveritare	-Zhvillimi ekonomik dhe rritja e punësimit në komunë. -Përmirësimi dhe ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të pronarëve të kullave, bujtinave, hoteleve në	-Mungesa e mjeteve financiare . -Procedurat administrative dhe aplikuese të vështira. -Mungesa e kuadrove apo ikja e tyre jashtë vendit.

	vendore dhe ndërkombëtare		vendore dhe ndërkombëtare -Biznese Lokale dhe Ndërkombëtare	komunë si zona rurale dhe malore. -Hapja e bizneseve të reja. -Krijimi i mundësive më të mira për qytetarët dhe bizneset.	
21.Organizmi për ditën e Çlirimit të Deçanit – Ngjitja në Via Ferrata	Komuna e Deçanit DEZH	Qershor 2024	Komuna e Deçanit DEZH	-Promovimi i atraksionit turistik Via Ferrata në Deçan -Respektimi i të gjithë atyre që kontribuan në çlirimin e Deçanit përmes micave me logo të komunës dhe ngjitja simbolike në pjesën ku shihet qyteti i Deçanit nga Kërrshat e Qelisë -Promovimi i bukurive natyrore të Deçanit, gjatë ngjitjes dhe gjatë pjesës së hikingut	-Mos pjesëmarrja në organizim -Kushtet klimatike
22.Organizimi i Koncertit për ditën e Çlirimit të Deçanit	Komuna e Deçanit DEZH DRKS	Qershor 2024	Komuna e Deçanit DEZH DRKS	-Përmes koncertit që do të mbahet në sheshin e qyteti, komuna e Deçanit mundohet që të promovoj edhe artistët e rinj nga qyteti i Deçanit	-Mos pjesëmarrja në organizim -Kushtet klimatike -Mungesa e financimit për organizim
23.Organizmi i ecjeve në të gjitha bjeshkët e komunës së Deçanit nga	Komuna e Deçanit	Janar - Dhjetor 2024	Komuna e Deçanit Visit Deçani Shoqatat bjeshkatore	-Promovimi i potencialit turistik të bjeshkëve nga Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna -Lëvizjen e njerëzve me qëllim rekreacioni, argëtimi,	-Kushtet klimatike jo të favorshme -Mungesa e sigurimit të fondeve -Mungesa e interesimit për të marrë pjesë në aktivitete

Sektori i Turizmit -Visit Deçani				dhe zgjerimi të njohurive kulturore etj.	që do organizohen gjatë 12 muajve të vitit.
24. Organizimi i Javës së Turizmit	Komuna e Deçanit	Gusht-Tetor 2024	Komuna e Deçanit Organizatat vendore dhe ndërkombëtare	-Promovimi i vlerave nga potenciali turistik natyror si dhe kulturor nga Komuna e Deçanit	-Kushtet klimatike -Mungesa e sigurimit të fondeve për organizmin e aktiviteteve që planifikojmë
25.Trajnimet në Qendrën e Informuese Turistike	Komuna e Deçanit	Mars-Shtator 2024	Komuna e Deçanit Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetarët e Komunës së Deçanit	-Trajnimi i menaxherëve të gastronomisë në lidhje me promovimin e produkteve të tyre në platformat ndërkombëtare të internetit -Njoftimi i tyre në lidhje me reklamën e produkteve dhe rëndësia e promovimit në website ndërkombëtare të internetit	-Mos pjesëmarrja e tyre në trajnim -Mungesa e fondeve për organizmin e trajnimeve
26.Aktiviteti në Lundërim (kajakim)	Komuna e Deçanit Visit Deçani Organizata Jo – Qeveritare Vendore	Korrik-Gusht 2024	Komuna e Deçanit Visit Deçani Organizatat Jo-Qeveritare Vendore	Aktiviteti me Kayak synon të zhvillojë turizmin në Deçan duke ofruar eksperiencën e lundërimit në ujë. Ky aktivitet ka potencial për të rritur numrin e turistëve dhe të ndikoj pozitivisht në ekonominë lokale. Është e rëndësishme të kujdesemi për sigurinë e pjesëmarrësve dhe trajnimin	-Rreziqet e sigurisë: Lundërimi (kajakimi) është një avanturë në ujë, dhe rreziqet e sigurisë përfshijnë mbi ngarkesën e kajakëve, mbi ngarkesën në ujë, dhe incidente të mundshme. -Ndikimi i kushteve të motit: kushtet e motit jo të favorshme mund të jenë një rrezik për pjesëmarrësit, duke përfshirë rreziqet e

				e tyre përpara se të fillojë aktiviteti. Presim që ky aktivitet të promovojë bukurinë natyrore dhe burimet ujore të zonës. Investimi në infrastrukturë dhe promovimi i aktivitetit mund të sjellë avantazhe afatgjata për turizmin në Deçan.	stuhive të papritura dhe kushteve të vështira të ujit. -Mungesa e përvojës së pjesëmarrësve: pjesëmarrësit me përvojë të kufizuar në Kayak mund të jenë më të rrezikuar për aksidente. -Rreziqet mjedisore: ruajtja e mjedisit dhe mbrojtja e ekosistemit ujqor është e rëndësishme për të parandaluar dëmtimin e natyrës. -Rregullator të mangët: rregullimet dhe ligjet e përshtatshme për sigurinë e aktiviteteve me Kayak janë të rëndësishme për të zvogëluar rreziqet dhe për të siguruar që aktiviteti të jetë i sigurt për të gjithë.
27.Aktivitet nëpër shkolla për promovimin e turizmit	Komuna e Deçanit	Mars 2024	Komuna e Deçanit Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare	-Përmes aktiviteteve nëpër shkollat e Komunës së Deçanit, synojmë të arrijmë në informimin sa më të saktë dhe orientimin e të rinjëve në trajnimin e guidave që do të kontribuojnë në	-Mungesa e interesimit nga të rinjtë -Mungesa e sigurimit të fondeve për realizimin e aktiviteteve etj.

				promovimin e turizmit nga potenciali i bukurive të bjeshkëve tona.	
28.Aktiviteti i Hipizimit	Komuna e Deçanit Visit Deçani Organizata Jo – Qeveritare Vendore	Qershor-Shtator 2024	Komuna e Deçanit Visit Deçani Organizata Jo – Qeveritare Vendore	-Nxitja e turizmit rural Hipizmi mund të ndihmojë në nxitjen e turizmit në zonat rurale të komunës duke ofruar një përvojë të veçantë të udhëtimit në natyrë. -Promovimi i trashëgimisë kulturore Aktiviteti i hipizmit mund të inkurajojë njohjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të qytetit, duke përfshirë traditat dhe ngjarjet historike. -Rritja e të ardhurave për komunën Nëse ky aktivitet zhvillohet me sukses, mund të sjellë rritje të të ardhurave për komunën përmes taksave dhe shërbimeve të ofruara për turistët.	-Siguria e udhëtimit: Hipizmi ka rreziqe të sigurisë për pjesëmarrësit, përfshirë rrezikun e rrëzimit nga kuajt, ngjarje të papritura të kuajve, dhe të tjera. -Ndikimi në mjedis Hipizmi mund të ketë ndikim të madh në mjedisin natyror, veçanërisht nëse nuk zbatohen praktikatat e qëndrueshme të udhëtimit. -Kujdesi për kuajt Kujdesi dhe trajtimi i duhur i kuajve është thelbësor për sigurinë e tyre dhe të pjesëmarrësve. -Rregullatorë të mangët Mungesa e rregullimeve dhe rregullatorëve të duhur mund të shpie në situata të paqarta dhe rreziqe të këtij aktiviteti.
29.Aktiviteti i Raftingut	Komuna e Deçanit	Mars-Tetor 2024	Komuna e Deçanit	-Nxitja e turizmit të aventurës Aktiviteti i	-Siguria e pjesëmarrësve Raftingu është një aktivitet

	Visit Deçani Organizata Jo – Qeveritare Vendore		Visit Deçani Organizata Jo – Qeveritare Vendore	raftingut do të nxitë turistët të vijnë në komunë për të përjetuar emocionet e raftingut në lumin e bukur të Deçanit. -Rritja e njohurisë së zonës Ky aktivitet do të ndihmojë në rritjen e njohurisë së zonës së Deçanit si destinacion turistik për aventurierët dhe adhuruesit e natyrës. -Rritja e të ardhurave lokale: Nëse raftingu bëhet një atraksion i suksesshëm, do të sjellë të ardhura të reja për komunën përmes taksave dhe shërbimeve të ofruara për turistët.	aventuristik me rreziqe të sigurisë. Rreziku i rënies nga gomoni dhe ngjarje të tjera të papritura mund të ndodhin. -Ndikimi në mjedis Raftingu mund të ketë ndikim të madh në mjedisin natyror, duke përfshirë ndotjen e ujërave dhe marrjen e shkëmbinjve të natyrshëm. -Mungesa e infrastrukturës: Mungesa e infrastrukturës dhe shërbimeve të nevojshme për raftingun mund të bëjë këtë aktivitet më të vështirë për të organizuar dhe për pjesëmarrësit.
30.Dita e Gështenjës	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatrat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetaret e	Tetor 2024	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatrat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetarët e	-Ruajtja e promovimi i produkteve natyrore. -Fuqizimi i bizneseve për grumbullim dhe shitjen e gështenjës. -Rritjen e numrit të turistëve në zonat rurale. -Zhvillimi ekonomik i komunës.	-Kushtet klimatike. -Mungesa e mbështetjes financiare. -Mos interesim për ruajtjen dhe shitjen e produkteve natyrore dhe vendore.

	Komunës se Deçanit Bizneset Lokale Ekspert të ndryshëm Tour Operator vendor dhe ndërkombëtar		Komunës së Deçanit		
--	---	--	-----------------------	--	--

➤ **Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër**

Shefi i Shërbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referenten e ndryshimeve kadastrale

Meqenëse Drejtoria jone kryesisht punon ne baze te kërkesave te palëve, nuk kemi mundësi reale qe te caktojmë volumin e punëve për vitin 2024, por ne duke u bazuar ne statistikat qe i mbajnë për çdo vit mendojmë se ne këtë vit do te ketë trend te rritjes se volumit te punëve krahasuar me vitet paraprake.

Ne vazhdim ne baze te punëve te kryera ne vitet e kaluar dhe bazuar ne trendin e rritjes se kërkesave te palëve po japin një pasqyre e cila do na shërbeje si orientim i synimeve te kryerjes se punëve brenda vitit planifikues dhe atë për secilin vend pune.

Zyrtari për RDPP - njëkohësisht Shefi i Drejtorisë për Kadastër dhe Zyrtarja e Ndërrimeve Kadastrale planifikojnë qe ne këtë vit te shqyrtoi përafërsisht 800-920 kërkesa te palëve te cilat kane te bëjnë me ndërrimin e pronareve dhe futjen e te dhënave te reja ne sistemin e SIKTK.

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit te shërbimit i dhe se bashku me Referentin për ndryshime kadastrale kryejnë edhe pune tjera me urdhër te drejtorit dhe sipas nevojës .

Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë dy zyrtarë për mirëmbajtjen e Kadastrit.

Këta zyrtar gjate periudhës 01.01.2024 deri 31.12.2024, mendojmë se do kryejnë afro 355 raste terreni sipas kërkesës se palëve për te cilat do bëjnë azhurnimin adekuat neper librat kadastral dhe me pas për këto lëndë nxjerrin vendime adekuate.

Punët ne terren do i kryejnë Kompanitë dhe Gjeodetët e Licencuar për shkak se me ligj kjo pune i'u është lënë vetëm gjeodetëve dhe kompanive gjeodete dhe gjeodetëve të licencuar.

Gjithashtu këta zyrtar mendojmë se do kryejnë me tepër se 50 raste te lëshuarjes se historiateve si dhe do dalin ne terren sipas nevojave dhe kërkesave zyrtare te komunës.

Te njëjtit do kryejne edhe detyra tjera sipas nevojave te cilat paraqiten ne këtë shërbim siç janë lëshuarja e kopjeve të planit konsultat me pale dhe pune tjera ne zyre.

Referenti për pranimin e palëve

Gjate kësaj periudhe, referenti për pranimin e palëve mendon se do pranoje përafërsisht 4700 kërkesa te cilat kryesisht kane te bëjnë me dhënien e certifikatave te pronës se paluajtshme, kopjeve te planit dhe vërtetimeve me te cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri te paluajtshme, ne territorin e komunës etj. I njëjti zyrtar i procedon te gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët pajisen me dokumente përkatëse ne afatin brenda ditës se paraqitjes se kërkesës.

Ky plan i punës nuk parasheh 100% punët qe do kryhen gjate vitit 2023 por siç u tha edhe me lartë është plan orientues i cili është përpiluar duke u bazuar ne statistikat e punëve te kryera nga vitet paraprake i qe shihet se për secilin vit ka tendenca te rritjes volumit te punës.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Deçanit përbëhet nga këta sektorë: Sektori për Kulturë, për Rini, për Sport, për Arkivë dhe sektori për Bibliotekë.

DKRS në Komunën e Deçanit ka planifikuar qëllimet dhe objektivat e saj për këtë vit, e të cilat janë:

- Ngritja e nivelit të performanës së Ansamblit;
- Avancimi i bashkëpunimit me OJQ-të;
- Mbështetja e Klubeve të Sportit;
- Respektimi i kalendarit të festave të vendit;
- Funksionalizimi i "Kolonisë së Artistëve";
- Vendosja e paneleve informuese të disa nga objektet e trashëgimisë;

DKRS do të jetë përgjegjëse në punën e saj, në mënyrë që objektivat e parashikuara të arrihen.

Aktivitetet që do të mbahen gjatë vitit 2024:

Nr.	Aktivitetet	Data
1.	"Dita e Pavarësisë"	17.02.2024
2.	Gara e Skitarisë "Kupa e Gjeravicës"	Shkurt – Mars
3.	"Epopeja e Dukagjinit"	24.02.2024
4.	"Dita e Dëshmorëve"	06.05.2024
5.	"Dita e Fëmijëve"	01.06.2024
6.	"Dita e Çlirimit"	16.06.2024
7.	"Ditët e Kulturës dhe Turizmit në Deçan"	Korrik – Gusht
8.	Festivali "Eshkë e Ndezur mbi Shkëlzen"	Korrik – Gusht
9.	"Dita e Gështenjës"	Tetor - Nëntor

10.	"28 Nëntori-Dita e Flamurit"	28.11.2024
11.	"Sportisti i Vitit"	Dhjetor
12.	Koncert nga AKV-"Deçani"	Dhjetor

DKRS gjatë vitit do të mbajë edhe aktivitete tjera, si: Promovime librash, Ekspozita, Ndarje të mirënjohjeve dhe shpërblimeve për rezultatet e arritura në kulturë, rini dhe sport.

Do të bëhet edhe përcjellja e aktiviteteve sportive të klubeve sportive të qytetit, po ashtu do të bëhet edhe monitorimi i objekteve të trashëgimisë kulturore. Sigurimi i te dhënave për ndërhyrje në këto objekte.